



VENDIM MBI KËRKESËN PËR RISHQYRTIM

Data e miratimit: 10 nëntor 2014

Numri i lëndës: 2013-27

Shaban Kadriu

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 10 nëntor 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 27 dhjetor 2013.

2. Më 27 maj 2014, Paneli ka gjetur këtë ankesë të papranueshme. Paneli ka gjetur se nuk kishte kompetencë për të shqyrtuar ankesën, pasi në parim Paneli nuk mund të shqyrtojë procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë që të shqyrtoj as aspektet administrative e as aspektet juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Prandaj, kjo ankesë bie jashtë juridiksionit të Panelit, sipas kuptimit të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës.
3. Më 1 tetor 2014, ankuesi ka kërkuar që të rishqyrtohej ankesa e tij sipas rregullit 42 të rregullores së punës së Panelit.

IV. LIGJI

Kërkesa për rishqyrtim

4. Ankuesi ka kërkuar nga Paneli që të bëjë rishqyrtimin e vendimit të tij të datës 27 maj 2014.
5. Përveç argumenteve të dhëna më parë, ankuesi pohon se ka marrë një vendim që e shpall kërkesën e tij të papranueshme vetëm atëherë pasi që iu ishte drejtuar EULEX-it, i cili ja kishte dhënë atij një kopje.
6. Prandaj, ankuesi kërkon që *"ky rast të shqyrtohet edhe një herë"*.
7. Nga informacionet e parashtruara, Paneli konkludon se ankuesi nuk ka treguar ndonjë fakt të ri që lidhet me rregullën 42 të rregullores së punës së Panelit. Ai vijon se ankuesi në këtë rast nuk ka vërtetuar se janë plotësuar kushtet për të bërë rishqyrtimin e vendimit të papranueshmërisë të Panelit të datës 27 maj 2014.

PËR KËTO ARSYE PANELI NJËZËRI

Refuzon kërkesën e ankuesit për rishqyrtim.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese